



PLANI PËR CILËSINË E AJRIT PËR PERIUDHËN

Viti 2018

KOMUNA E KËRÇOVËS



I Hyrje

Në bazë të Ligjit për menaxhim me ajrin, si dhe Rregulloren për përmbajtje detale dhe mënyrën e përgatitjes të planit për mbrojtjen e ajrit ambiental (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 148 të dt. 10.10.2014), të gjitha komunat janë të obliguara që të hartojnë plan komunal për cilësinë e ajrit, në pajtim me Planin nacional për cilësinë e ajrit. Ky plan duhet t’i japë udhëzimet komunale për realizimin e qëllimeve që janë të përcaktuara në nivel nacional.

Qëllimet e vendosura në Planin nacional për cilësinë e ajrit janë drejtpërdrejtë të lidhura me sigurimin e kushteve minimale për cilësinë e ajrit përmes zbatimit të standardeve, që implementohen në Unionin Evropian.

Programi njëvjetor që do të nxiret nga Plani, paraqet dokument themelor për planifikimin e aktiviteteve të ardhshme gjatë vitit kalendarik të planifikuar, si dhe bazë për përlogaritjen e pjesës nga Buxheti komunal, destinuar për qëllimet e dhëna në Programin për cilësinë e ajrit.

Komuna e Kërçovës gjendet në pjesën perëndimore të Republikës së Maqedonisë, lugina e Kërçovës paraqet tërësi qartë të rrethuar natyrore, nga të gjitha anët e rrethuara me male të larta dhe i takon rajonit të epërm të lumit Treska, në anën veriore prek deri te maja Strazhë dhe mali Bukovik dhe Dobra Vodë, në anën perëndimore gjendet mali Bistra, në anën jugore mali Babë, Saç dhe Musicë, ndërsa në anën lindore lugina prek pjesën veriore të Poreçes. Qyteti i Kërçovës si qendër urbane, gjendet në lartësi mbidetare prej 620-650 m., ndërsa vendbanimet tjera gjenden në lartësinë mbidetare prej 600 deri mbi 1000 m.

Përshkrim dhe vlerësim i gjendjes ekzistuese në lidhje me cilësinë e ajrit

Si ndotës kryesor në komunë ishte (dhe ende është) deponia e qytetit, për të cilën Komuna e Kërçovës gjeti zgjidhje të përkohshme, për të cilin problem përgatitëm elaborat për deponimin e përkohshëm të mbeturinave në gropën e “REK” Oslome, për pezullimin e mbeturinave komunale me mekanizma, është e obliguar ndërmarrja publike komunale “NP Komunalec” - Kërçovë.

Mbeturinat e grumbulluara N.P. “Komunalec” - Kërçovë i çon te gropa, që është destinuar për mbeturina të ngurta komunale, në distancë prej 15km prej Kërçove. Komuna rregullisht realizon



Plan për cilësinë e ajrit për periudhën 2018

aksione për pastrimin e deponive të zeza. Kjo zgjidhje do të vlej deri në realizimin e projektit “sistem i integruar dhe i vetëqëndrueshëm për menaxhim me mbeturinat në rajonin e Pellagonisë, Jugperëndimor, të Vardarit dhe të Shkupit, për të cilin Komuna e Kërçovës merr pjesë aktive dhe jemi në përgatitje për ndërtim, gjegjësisht vendosje të stacionit ngarkues në Komunën e Kërçovës.



Pastrimi i deponive të zeza

Pastrimi i deponive të zeza në Komunën e Kërçovës është masë për zvoglimin e ndotjes, si të ajrit, ashtu edhe të mjedisit jetësor, në këto aksione komuna i kyç përveç institucioneve, popullatën vendase dhe popullatën më të re, arsimin, me qëllim edukimin për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Masë relevante dhe efikase e zbatueshme në mbrojtjen e ajrit atmosferik, në mënyrë shumë efikase e përmirësojmë me mbjelljen e parqeve, të cilat në masë të madhe janë të përfaqësuara gjelbërimet, ku mbjellen drunjtë, rrugët e qytetit nga të dy anët janë të rrethuara me drunj të mbjellur, ndërsa anësh rrugëve magjistrale dhe shtetërore, formohen rripa mbrojtës.

Si masë Komuna e Kërçovës hartoi edhe hulumtim për ripërpunimin e mbeturinave ndërtimore.

Zvoglimin e emisioneve nga komunikacioni për lloj të caktuar të automobilave, veçanërisht në mjedise urbane.

-Menaxhimi me protokolin e trafikut (duke kyçur përcaktimin e çmimeve për ngecjen në trafik) diferencimin e çmimeve për parkim.

-Stimulime tjera ekonomike dhe formimin e zonave me emision të vogël

-Kufizimin e shpejtësisë në trafik.

-Ndërtimi i rrugëve të reja,

-Rikonstruimi i trafikut në rajone të caktuara.



Plan për cilësinë e ajrit për periudhën 2018

Me atë fitojmë reduktim të emisioneve nga automjetet me montim shtesë të paisjes për kontroll të emisioneve, me çka duhet të shqyrtohet shfrytëzimi i stimulimeve ekonomike që të shpejtohet zvoglimi i emisioneve dhe masa tjera.

Kontroll mbi kapacitetet industriale

Komuna udhëheq regjistër për çdo instalim, që punon në territorin e Komunës së Kërçovës.

Me vetë fitimin e B lejes, ose elaborat ekologjik, instalimi obligohet që të bëjë monitorim të ndotjes.

-Pyllëzimin si aksion të rregullt dhe obligues.

-Rregullimin dhe gjelbërimin e parqeve.



Gjendje me zgjedhjen dhe riciklimin e mbeturinave komunale në Komunën e Kërçovës

Në Komunën e Kërçovës deri më tash bëhet zgjedhje e letrës. Sipas të dhënave nga Komuna, në javë zgjedhen 9000-9500kg letër. Për atë qëllim, në ato pjesë të qytetit ku frekuenca është më e madhe dhe ku në pjesë më të madhe banorët janë të vendosur në objekte kolektive të banimit, janë të vendosur 15 kontejnerë për mbeturina nga plastika (shishe plastike dhe ambalazh tjetër nga plastika).



Parashikime të gjendjeve të ardhshme me menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Kërçovës

Sipas të dhënave statistikore, gjendja me numrin e popullatës së shërbyer, në krahasim me numrin e popullatës së shërbyer me shërbimin grumbullim, transport dhe deponim të mbeturinave të ngurta komunale në Komunën e Kërçovës është si vijon:



Plan për cilësinë e ajrit për periudhën 2018

Komuna	Gjithsej banorë		Gjithsej popullatë e shërbyer	Gjithsej popullatë jo e shërbyer
Kërçovë	Pjesë urbane	28969	28969	0
	Rurale	3392	984	2407
Gjithsej		32361	29954	2407

Masa stimulative për zvoglimin dhe për largimin e shkaktimit të mbeturinave, shfrytëzimin e përsëritshëm të tyre, reciklimin ose shfrytëzimin si burim të energjisë

- Zvoglimin e mbeturinave bioshpënzuese që deponohen deri në 75%
- Ripërpunim i mbeturinave nga ambalazhi në 50%
- Trajtim dhe shfrytëzim i përsëritshëm i automjeteve për mbledhjen e mbeturinave deri në 70%

Definimi i indikatorëve përmes të cilëve do të ndiqet realizimi i Planit dhe Programit

Indikatorë për sukses duhet të jenë edhe treguesë të caktuar që duhet të jenë të matshëm për të mundur të ndiqet (mos) realizimi i planit. Kjo para së gjithash ka të bëjë me vendosjen e shërbimeve. Këtu do të jenë të paraqitur më shumë shembuj për indikatorë, në bazë të propozimaksioneve.

- Indikator për pastrimin, rregullimin dhe gjelbërimin e parqeve
- Mbjelljen e drunjëve të rinj me pyje pishe.
- Aksione obligative ekologjike për rregullimin e oborreve dhe parqeve
- Dmth. planifikohet që të gjelbërohen 20% të reja nga vendet e pagjelbëruara.

1. Analizë dhe propozim për mënyrë më adekuate të cilësisë së ajrit

Definim i mënyrës më adekuate të cilësisë së ajrit për Komunën e Kërçovës, para së gjithash duhet të varet nga mundësitë reale për implementim të detyrës kështu të vendosur. Llogaritet se pas të gjitha bazave (institucionale, organizative, financiare, teknike, si dhe resurse njerëzore). Në situatë të atillë duhet që ajo që është kërkesë e direktivave të UE-së dhe të Planit nacionale për cilësinë e ajrit, të shëndrrohet në koncept që minimum do t'i kënaqë këto kritere dhe do të tregojë se Komuna e Kërçovës në kuadër të mundësive të veta reale do të japë kontribut të vet në afrimin drejt UE-së me ngritjen e shkallës të mbrojtjes së mjedisit jetësor nga ndikimet negative. Në përgjithësi, koncepti i periudhës planifikuese duhet të jetë i drejtuar në tri drejtime:



1. Lokalizim i ndotjes jashtë masës
2. Natyra dhe vlerësim i ndotjes
3. Detaje për masa ose projekte për përmirësimin e cilësisë së ajrit
 - Kalkulimi i të gjitha shpenzimeve të krijuara përgjatë menaxhimit me mbeturinat gjatë formimit të çmimit të shërbimit;
 - Në mënyrë të shkallëzuar zgjedhjen e mbeturinave komunale në vendin e krijimit (familje, industri dhe institucione) dhe
 - Zgjidhje rajonale të sistemit për menaxhim me mbeturinat ndërtimore për të cilën Komuna e Kërçovës ka të përgatitur hulumtim.

1.1 Propozime në lidhje me financat

Zbatimi i Planit dhe Programit për cilësinë e ajrit në Komunën e Kërçovës, është shumë i kufizuar nga aspekti i mundësive financiare të komunës. Komuna ende nuk është sa duhet financiarisht e fuqishme që të mund të përkrahë projekte të këtilla në mënyrë vetanake të këtij vëllimi, që shihet edhe nga analizat financiare. Megjithatë i ngelet komunës që të gjejë zgjidhjen më të mirë të mundshme për mbylljen e konstruksionit financiar rreth financimit të Planit dhe Programit për cilësinë e ajrit.

Mënyra në të cilën duhet kjo të bëhet është fushatë aktive për promovimin e Planit dhe Programit, theksimin e rëndësisë së tyre për komunën, organizimin e konferencave të donatorëve dhe të ngjajshme. Të gjitha këto aktivitete që duhet të ndërmerren për të rezultuar me gjetjen e investitorëve të interesuar.

2. **Definim i aksioneve gjegjësisht projekte me të cilat do të realizohen aktivitetet e theksuara me prioritizim të kryer**



1. Vetëdija publike	Fillimi i fushatave për ajër ambiental	Fushatë për ajër të pastër	Fushatë për mjedis më të pastër jetësor	Fushatë për mjedis më të pastër jetësor	Fushatë për mjedis më të pastër jetësor
2. Monitorim dhe informim	Ndjekje e indikatorëve	Ndjekje e indikatorëve	Ndjekje e indikatorëve	Ndjekje e indikatorëve	Ndjekje e indikatorëve
3. Aspekti financiar	Organizimi i konferencave të donatorëve, gjetjen e investitorëve të interesuar për realizimin e Planit dhe Programit. Angazhimi i konsulentëve për realizimin e fushatës për publikun.	Regjistrimi i kapitalit themeltar për NPK rajonale, përgatitja e buxhetit për investimin. Angazhimi i konsulentëve për realizimin e fushatës për publikun.	Angazhimi i konsulentëve për realizimin e fushatës për publikun.	Kuantifikim i nevojave për paisje dhe përlogaritje për furnizim të tyre në pajtim me çmimet e tregut në fuqi. Angazhimi i konsulentëve për realizimin e fushatës për publikun.	Angazhimi i konsulentëve për realizimin e fushatës për publikun.

Temat të cilat do të përfshihen në emisionet janë ato të cilat janë të përfshira në vetë dokumentin „Plan dhe Program për cilësinë e ajrit në Komunën e Kërçovës”. Emisionet do të jenë në dy cikle, me çka cikli i parë i emisioneve do të jetë me qëllim të prezentimit të aktiviteteve që do të jenë të ndërmarra, ndërsa në ciklin e dytë do të jenë të prezentuar rezultatet e arritura nga ato aktivitete.

- Faza e parë:

- Zgjidhje afatgjate për deponinë, përmes projektit Vendosija e sistemit të integruar dhe vetë-mirëmbajtës për menaxhimin me mbeturinat në Rajonin e Pellagonisë, Jugperëndimor, të Vardarit dhe të Shkupit.
- Ndërtim, gjegjësisht vendosje të stacionit ngarkues.
- Reduktim të emisioneve nga automjetet.
- Kontrolle të shpeshtuara të monitorimit obligativ të ndotjes nga industria.
- Bisedime dhe hulumtime për vendosjen e gazifikimit.

- Faza e dytë:

- Punëtori njëditore – trajnim i kuadrit mësimor në shkollat fillore që do t'i përfshijë aktivitetet vijuese:
- Arsimitarë të shkollave fillore që do të tregojnë interes për projektin do të marrin pjesë në punëtori, me qëllim trajnimin e tyre për realizimin e punës në kuadër të shkollave në temë “Cilësia e ajrit”;
- Trajnimi do t'i përfshijë temat vijuese: gjendje e tashme në lëminë me cilësinë e ajrit, aspektin shëndetësor dhe ekologjik të cilësisë së ajrit, nevojë për minimizimin e ndotjes, ndryshimin e veseve të ndotësve, efekte negative dhe trajtim jo të rregullt të natyrës, ndryshim të patjetërsueshëm të sjelljes ndaj mjedisit jetësor etj.;
- Emitimin e ciklit të dytë të emisioneve në radio dhe në televizion; dhe
- Web prezentim të aktiviteteve të realizuara dhe rezultateve të arritura.



- *Faza e tretë:*

Ndërmarrja e aktiviteteve konkrete që do ta finalizojnë fushatën publike:

- Thirrje drejt popullatës lokale për pjesëmarrje në aksionin për grumbullim të materialeve të ricikluara;
- Organizim nga ana e kuadrit arsimor sëbashku me nxënësit dhe zbatim praktik të përvojave të fituara nga trajnimet dhe punëtoritë;
- Shpërblime nga ana e komunës;
- Web prezentim të aktiviteteve të realizuara dhe rezultateve të arritura në këtë fazë.

Rezultate të pritura nga fushata publike:

- Modul i zhvilluar për edukim të popullatës për problemet në mjedisin jetësor;
- Modul i zhvilluar për edukim të kuadrit arsimor për edukim të nxënësve në shkollat fillore për cilësinë e ajrit. Vetëdije të zhvilluar të punonjësve të arsimit për nevojën nga edukimi intenziv;
- Nivel më i lartë i vetëdijes te popullata më e re dhe publiku më i gjerë për cilësinë e ajrit. Interes më i madh i popullatës për problemet në mjedisin jetësor dhe pjesëmarrje në aksionet në nivel të komunës;
- Vetëdije e zhvilluar e mediave për nevojën nga pjesëmarrja dhe informimi gjithëpërfshirës i publikut për të gjitha aspektet për mbrojtjen e mjedisit jetësor (në veçanti për cilësinë e ajrit) dhe ndodhitë aktuale në atë fushë;
- Vendorsja e bashkëpunimit me sektorin e OJQ, vetëqeverisjen lokale, mediat, NP „Komunalec” – Kërçovë, sektorin privat dhe të gjithë të interesuarit në procesin për ngritjen e vetëdijes publike për cilësinë e ajrit.

Procesi i ngritjes së vetëdijes publike është i patjetërsueshëm të vazhdohet dhe të pasurohet me përmbajtje të reja nga lëmia e mjedisit jetësor.